



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të lartë dhe Shkencës, Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit administrativ nr. 27/2016, dt. 22.11.2016 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT për botime dhe publikime shkencore, shpall:

KONKURS

(Për financimin e botimeve dhe publikimeve shkencore për vitin 2026)

Fushat shkencore prioritare për aplikim

Financohen botime ose përkthime nga fushat prioritare shkencore të parapara në Programin Kombëtar të Shkencës:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor

3. Studimet mjekësore
4. Studimet ekonomike dhe sociale
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike
6. Hulumtime ndërdisiplinare për teknologjitë e komunikimit dhe informacionit.

Kriteret dhe procedurat për botim:

- Të drejtë aplikimi kanë autorët me shtetësi kosovare, me vepra shkencore (monografi shkencore), përmbledhje punimesh shkencore (që i bashkon një temë - libra tematikë shkencorë) dhe me përkthime të veprave shkencore të autorëve kosovarë dhe të huaj (gjuhë e huaj - shqip/serbisht dhe shqip/serbisht - gjuhë e huaj), kurse institucionet shkencore të Republikës së Kosovës mund të konkurrojnë me revista shkencore, të cilat botohen dhe përmbushin standarde të njohura ndërkombëtare;
- Me përkthime të veprave shkencore, mund të konkurrojnë edhe autorë që janë jashtë vendit, nëse veprat e tyre shkencore me përmbajtjen e tyre, i referohen në mënyrë të qartë Republikës së Kosovës. Në një rast të tillë, aplikimin duhet ta dorëzojë njëri nga autorët apo recensentët që punojnë në Republikën e Kosovës;
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim;
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim;
- Institucionet shkencore mund të aplikojnë me vetëm një numër reviste duke iu përmbajtur kritereve dhe procedurave për përkthim në gjuhë të huaja;
- Mbështeten botimet ose përkthimet që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që botimi/përkthimi i tyre nuk do të ishte i mundur pa mbështetje financiare. Merren në konsideratë për botim përkthimet e monografive shkencore dhe publikimeve tjera konform Udhëzimit administrativ (MASHT) nr. 27 /2016 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT për botime dhe publikime shkencore.

Përkthimet:

- Mbështeten përkthime në një gjuhë të huaj me reputacion ndërkombëtar;
- Përkthimi duhet të bëhet nga një njohës me eksperiencë të gjuhës përkatëse dhe kjo të konfirmohet me dëshmi përkatëse duke ofruar bibliografitë e përkthyesve;
- Financohen përkthimet që shquhen për cilësi të lartë shkencore që kanë relevancë në promovimin e vlerave historike, gjuhësore, kulturore dhe shkencore të Kosovës;
- Pajtimin e shtëpisë botuese të vendit ku botohet punimi shkencor si dhe definimin e të drejtës së autorit;
- Cilësia shkencore e punimit garantohet së paku nga **tri recensionet**.

Kush mund të aplikojë?

- Aplikimet për botime të veçanta bëhen vetëm prej personit fizik.
- Merren parasysh botimet e individëve dhe institucioneve që e ushtrojnë veprimtarinë shkencore në Republikën e Kosovës.
- Aplikimi bëhet vetëm prej autorit (redaktorit).

Aplikacionet për botim duhet të kenë këto dokumente:

- Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja);
- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit apo institucionit;
- Tri recensionet të punimit (dy vendore dhe një ndërkombëtare);
- Pajtimin e shtëpisë botuese si dhe definimin e të drejtës së autorit;
- Deklarata e noterizuar nga autori që dorëshkrimi i librit/punimit nuk është i botuar pjesërisht apo tërësisht më herët;
- Dy kopje të dorëshkrimit të përfunduar dhe të gatshëm për botim, (dorëshkrimet e papërfunduara nuk do të shqyrtohen);
- Një kopje e versionit final në formë elektronike (USB).

Konkursi mbetet i hapur nga **dt.14.05.2026-04.06.2026**

Formularin dhe dokumentacionin shtesë mund ta gjeni në webfaqen e MASH-it:

<https://mash.rks-gov.net/alldocuments/formulari-per-botime-2026/>

Aplikacioni me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e MASH-it, zyra nr. 4, ndërsa të gjitha informatat rreth aplikimit merren në zyrën nr. 302/b, kati 3 te z. Fidan Kozhani.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe aplikimi me vonesë nuk shqyrtohen.

Detajet e Kontaktit;

Emri: Fidan Kozhani

Posta elektronike :

e-mail: fidan.kozhani@rks-gov.net , Adresa postare:

Rr. Agim Ramadani p. n 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+381(0) 38 600 65082